



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Roza Komani B.I lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i stadiumit në Novosellë”, Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. REFUZOHET SI E PABAZUAR** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik Roza Komani B.I e dt.20.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i stadiumit në Novosellë”, Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 12.08.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. VËRTETOHET** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, TË PUBLIKUAR ME DATË: 12.08.2026;
- 3.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik Roza Komani B.I me dt.20.08.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i stadiumit në Novosellë”, Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 21.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka konstatuar se:

- Pretendimi juaj 7.1 lidhur me kërkesën PAS99:2012, vlerësohet si i pabazuar;

- Pretendimi juaj 7.2 lidhur me kërkesat e detajuara dhe të ngushta për pajisjet vlerësohet si i pabazuar;

- Pretendimi juaj 7.3 lidhur me kërkesën për korrigjim të Dosjes së Tenderit vlerësohet si i pabazuar.

Të gjitha pretendimet tuaja lidhur me kërkesat e parashtruara përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim janë të pabazuara, pasi që, duke marrë parasysh natyrën e punëve dhe mënyrën e realizimit të kontratës, kapacitetet dhe mjetet e përcaktuara në dosjen e tenderit janë të domosdoshme për realizimin e punëve sipas kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Për këtë arsye, kërkesa për zëvendësimin e mjeteve të përcaktuara me mjete të tjera, pa u dëshmuar se ato mund të përmbushin në mënyrë të plotë dhe të barasvlershme funksionet dhe kërkesat teknike të kërkuara, nuk mund të aprovohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).